



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU
ENERGY REGULATORY OFFICE



Prishtinë, 27 shkurt 2026
Kodi i ZRRE-së: V_3092_2026

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,

Duke marrë parasysh:

- Dispozitat e Nenit 9 paragrafi 1, nënparagrafi 1.7, Neni 15, Nenin 26, Nenit 28 paragrafi 2, nënparagrafi 2.1, Nenin 30, Nenin 32 paragrafin 2 nënparagrafi 2.1, Nenin 34 dhe Nenin 38 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr. 05/L-084);
- Dispozitat e Nenit 6 të Ligjit për Energjinë Elektrike (Ligji Nr. 05/L-085);
- Dispozitat e Rregullës për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë (Rregulla Nr.07/2017);
- Marrëveshjen për Blerje të Energjisë Elektrike (MBA) të lidhur mes ndërmarrjes "MATKOS GROUP SH.P.K HC SHARRI - HC SHARRI dhe Operatori i Sistemit të Transmisionit dhe Tregut (KOSTT) SH.A, e datës 10.11.2017,
- Aplikacionin për Licencim të Aktivitetit të Prodhimit të Energjisë Elektrike të dorëzuar në Rregullator me datë 23 shkurt 2021 nga "MATKOS GROUP SH.P.K. HC SHARRI,
- AKTGJYKIMIN KA.nr.697/2025 të Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative, të datës 26.11.2025, dhe të pranuar nga Zyra e Rregullatorit për Energji përmes administratës Nr. 035/26 me datë 29 janar 2026,
- AKTGJYKIMIN K.DH.SH.II nr.1802/2025 të Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Dytë, të datës 05.01.2026, dhe të pranuar nga Zyra e Rregullatorit për Energji përmes administratës Nr. 035/26 me datë 29 janar 2026, dhe
- Kërkesën e MATKOS Group SH.P.K, të datës 12.01.2026 (nr.035/26), për lëshim të licencës për për MATKOS GROUP SH.P.K HC SHARRI, adresa: Rr.Shpetim Robaj, 10000 Prishtinë, (lokacioni i hidrocentralit: Shterpcë), Republika e Kosovës;

në seancën e mbajtur me datë 27 shkurt 2026 nxori këtë:

VENDIM

- I. LËSHOHET** Licencë për prodhim të energjisë elektrike nga burimet e ripërtërishme të energjisë nga Hidrocentrali "SHARRI" me kapacitet 6,453 MW, ndërmarrjes MATKOS GROUP HC SHARRI SH.P.K., me numër licence ZRRE/Li_74/21, për periudhën katërdhjetë (40) vjeçare, nga data 27.02.2026 deri me 26.02.2066.
- II. Obligohet** ndërmarrja të sjell në Rregullator çdo dokument të lëshuar nga institucione të ndryshme për MATKOS GROUP HC SHARRI SH.P.K. të cilët mund të kenë ndikim në validitetin dhe periudhën e vlefshmërisë së licencës së lëshuar, si dhe çdo dokument i cili mund të ndryshoj nga ai i sjellë gjatë aplikimit për marrje të licencës.



Arsyetim

- Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) me datë 12.01.2026 ka pranuar kërkesën nga aplikuesi MATKOS GROUP HC SHARRI SH.P.K. për pajisje me Licencë për Prodhim të Energjisë Elektrike, me të cilën aplikuesi ka njoftuar Rregullatorin për përfundimin e procedurës gjyqësore dhe ka kërkuar vazhdimin e procedurës së licencimit në përputhje me Rregullën për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë.
- Në këtë kërkesë, aplikuesi ka deklaruar se kushti ligjor për Leje Mjedisore konsiderohet i përmbushur, duke u bazuar në aktgjykimet përfundimtare gjyqësore, të cilat i ka bashkëngjitur si prova zyrtare dhe me të cilat është vërtetuar se Leja Mjedisore është fituar në mënyrë ligjore, me efekt juridik nga koha e aplikimit.
- Pranimi i kësaj kërkesë dhe dokumentacionit shoqërues ka përbërë bazë procedurale për rishqyrtimin e aplikimit për licencë, në përputhje me gjendjen juridike të konstatuar nga gjykata.
- ZRRE fillimisht me datë 23.02.2021 kishte pranuar Aplikacionin me dëshmitë përkatëse për Licencim të aktivitetit të Prodhimit të energjisë elektrike në Kosovë nga Ndërmarrja MATKOS GROUP HC SHARRI SH.P.K. për hidrocentralin (HC) SHARRI, me kapacitet të instaluar prej **6.453 MW**, me lokacion të këtij Hidrocentrali në Shterpcë, Komuna e Shterpcës.
- ZRRE kishte vlerësuar se ndërmarrja në fjalë ka vepruar sipas udhëzimeve të Rregullatorit, kërkesave të parapara në Aplikacionin për Licencim të aktivitetit të prodhimit të energjisë elektrike dhe legjislacionit në fuqi, kështu që pas vlerësimit të aplikacionit dhe dëshmimeve tjera të bashkëngjitura, ka vërejtur se te pika ku kërkohet Leja Mjedisore, e njëjta nuk është sjellur nga aplikuesi.
- Për licencim të aktivitetit të prodhimit të energjisë elektrike, përveç tjerash kërkohet edhe Leja Mjedisore e Integruar e lëshuar nga institucionet përkatëse. ZRRE gjatë vlerësimit të aplikacionit të MATKOS GROUP HC SHARRI SH.P.K. ka kërkuar nga e njëjta që të sjell në ZRRE edhe Lejen Mjedisore, për çka MATKOS GROUP HC SHARRI SH.P.K. ka dorëzuar në ZRRE dokumentin *“SHTOJCA 1 FORMULARI I KËRKESËS PËR LEJE MJEDISORE”*, të datës 19.01.2021 si dëshmi se ka aplikuar në Ministri të Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH) për t’u pajisur me Leje Mjedisore nga kjo Ministri, për HC SHARRI.
- MATKOS GROUP HC SHARRI SH.P.K. që nga koha e aplikimit nuk ka arritur të sjell në ZRRE Lejen Mjedisore, për çka edhe nuk është licencuar nga ZRRE. E njëjta për shkak se kishte aplikuar në Ministrinë përkatëse për Leje Mjedisore dhe e njëjta nuk i ka kthyer përgjigje brenda afatit ligjor, kishte bërë padi në gjykatë për heshtje administrative, sipas Nenit 100 e lidhur me Nenin 46 paragrafin 3 të Ligjit Nr 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative në Kosovë.
- MATKOS GROUP HC SHARRI SH.P.K. bazuar në Aktgjykimet përfundimtare të Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë dhe të Dytë, me datë 12.01.2026 ka kërkuar nga ZRRE vazhdimin e procedurës për lëshimin e Licencës për Prodhim të Energjisë Elektrike, duke u bazuar në Aktgjykimin KA.nr.697/2025 të datës 26.11.2025 (i vërtetuar me Aktgjykimin K.DH.SH.II.nr.1802/2025 dt. 05.01.2026 i Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Dytë). Pra në bazë të këtij Aktgjykimi, Shoqërisë MATKOS GROUP SH.P.K HC SHARRI i është



aprovuar në tërësi kërkesëpadia dhe se Leja Mjedisore i ishte aprovuar në heshtje, që nga 06.03.2021, dhe se në bazë të aktit administrativ të miratuar në heshtje i ka pasur të gjitha autorizimet sikur të kishte pas aktin administrativ të shkruar për dhënien e Lejes Mjedisore. Leja Mjedisore ka fuqi juridike për periudhë prej pesë (5) vitesh.

- Gjithnjë sipas Aktgjykimin KA.nr.697/2025 gjykata ka vlerësuar se mundet me vendim ta konstatoj ekzistimit e aktit administrativ të miratuar në heshtje, si rrugë e vetme juridike e palës, dhe nuk është e nevojshme që pala të kërkoj nga gjykata që së pari ta detyroj autoritetin publik të nxjerr akt administrativ për të cilin ka rënë në heshtje. Gjukata gjithashtu ka vlerësuar se ligjërisht e ka për obligim që t'i ofroj mbrojtje gjyqësore subjektit i cili ka qenë i pajisur me aktin administrativ të miratuar në heshtje sipas kërkesës së tij, që nga momenti kur autoriteti publik e ka lëshuar afatin për dhënien e aktit administrativ në bazë të kërkesës fillestare. Në lidhje me këtë gjykata e ka parë të arsyeshme të sqaroj se pika III. e dispozitivit Aktgjykimit vetëm ka karakter deklarativ, pra vetëm konstaton ekzistimin e një akti administrativ, i cili tanimë veç në bazë të ligjit egziston. Pra kur organi administrativ dështon që të vendosë brenda afatit fillestar ose të shtyrë në mënyrë të rregullt nxjerrjen e vendimit të shkruar sipas kërkesës së palës, atëherë kërkesa e palës juridikisht në bazë të ligjit kondiserohet e aprovuar në tërësi.
- Po ashtu Gjukata në Aktgjykimin K.DH.SH.II.nr.1802/2025 (fq.8) ka theksuar Leja Mjedisore ishte miratuar në mënyrë të ligjshme me dt.06.03.2021 dhe se leja mjedisore ka fuqi juridike për një periudhë pesë (5) vjeçare në përputhje me Nenin 33 të Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit. Kjo do të thotë se paditësi ka të gjitha të drejtat që i garanton ligji, pa pasur nevojë që organi administrativ të ndërmarr ndonjë akt tjetër për të njohur këto të drejta. Gjukata përmes aktgjykimit thekson rëndësinë e respektimit rigoroz të afateve ligjore nga organet administrative dhe vlerës juridike të procedurës së miratimit në heshtje, si një instrument efektiv për mbrojtjen e të drejtave të qytetarëve dhe parandalimin e arbitraritetit administrativ.
- Bashkë me kërkesën drejtuar ZRRE-së për lëshim licence dhe aktgjykimet e gjykatave kompetente për heshtje administrative, pala ka dorëzuar në ZRRE edhe njoftimin zyrtar për plotfuqishmërinë e aktgjykimit, të lëshuar nga Gjukata Komerciale e Kosovës, të dt 27.01.2026, sipas të cilit citoj *"Aktgjykimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhoma e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative Ka.nr.697/2025 i datës 29.11.2025, i vërtetuar me Aktgjykimin e Dhomës së Shkallës së Dytë K.DH.SH.II.nr.1802/2025 i datës 05.01.2026 është i plotfuqishëm me datë 05.01.2026 dhe i ekzekutueshëm me datën 22.01.2026"*.
- Për këtë çështje, ZRRE me datë 09 shkurt 2026, ka kërkuar nga Ministria përkatëse kompetente për lëshim të Lejes Mjedisore, konfirmim institucional lidhur me njohjen dhe trajtimin nga kjo Ministri të Aktgjykimit të lëshuar nga Gjukata Kompetente për MATKOS GROUP HC SHARRI SH.P.K. ZRRE nuk ka pranuar përgjigje/konfirmim nga kjo ministri.
- Si rezultat i Aktgjykimeve përfundimtare: a) Kushti ligjor për Leje Mjedisore, i kërkuar nga Rregulla për Licencimin, është i përmbushur përmes Aktgjykimit; b) ZRRE është e obliguar që, në vlerësimin e aplikacionit për licencim, të marrë për bazë gjendjen juridike të konstatuar nga gjykata, dhe për këtë ka përfshirë dispozita të Aktgjykimeve gjyqësore në këtë vendim.
- Duke u bazuar në Aplikacionin për licencë, dokumentacionin e bashkangjitur sipas Rregullës për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë, dhe në aktgjykimet përfundimtare gjyqësore,



vlerësohet se kushtet ligjore për licencimin e aktivitetit të prodhimit të energjisë elektrike për MATKOS GROUP HC SHARRI SH.P.K., janë përmbushur.

- o Nisur nga sa më sipër, ZRRE duke marr parasysh se aktgjykimi në fjalë ka të bëjë me konstatimin e ekzistencës së Lejes Mjedisore përmes miratimit në heshtje, dhe se ky element përbën kusht ligjor për procedurën e licencimit, sipas Rregullës për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë, dhe duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij Vendimi.

III. Vendimi nxirret në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.

IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i Rregullatorit dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të Rregullatorit.


Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të Rregullatorit, cilado që ndodh e fundit.


Vendimi i dërgohet:


- Ndërmarrjes **MATKOS GROUP HC SHARRI SH.P.K.**,
- Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe
- Arkivit të Zyrës së Rregullatorit për Energji


Bordi i Rregullatorit:


Ymer Fejzullahu, Kryesues


Gani Buça, Anëtar


Lutfije Dervishi, Anëtare


Artan Isufi, Anëtare


Adnan Preniqi, Anëtar